



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality  
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



**Nr.13/511**

**Më: 03.08.2018**

**D r a g a s h**

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

**KONKURS- i rregullt**

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin parafillor, fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2018/2019.

**SHFMU "Samidin Emini"- Kuk**

1. Një mësimdhënës për mësim klasor në paralelen e ndarë fizike –Pllajnik.

**SHFMU " 28 Nëntori"- Bresanë**

1. Tre mësimdhënës për mësim klasor

**SHFMU "Ulina" –Kosavë**

1. Një mësimdhënës për mësim klasor

**SHFMU "Ilmi Bahtjari" – Blaç**

1. Një mësimdhënës për mësim klasor-paralelja e ndarë në Zgatar
2. Një edukatore për mësimin parafillor në paralelen e ndarë në Zaplluxhe (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)
3. Një mësimdhënës të matematikës ( deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)

**SHFMU "Fetah Sylejmani" Dragash**

1. Një mësimdhënës për mësim klasor
2. Një edukatore për mësimin parafillor në paralelen e ndarë në Rrenc
3. Dy mësimdhënës për Gjuhë Boshnjake

### **SHFMU "Sezai Surroi" Bellobrad**

1. Një mësimdhënës i lëndës së Biologjisë (10 orë)
2. Një mësimdhënës për mësim klasor
3. Një mësimdhënës për mësim klasor- paralelja e ndarë në Brrut (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)
4. Një edukatore për mësimin parafillor në paralelen e ndarë në Zym

### **SHFMU "9 Maji" Rapçë**

1. Një mësimdhënës për mësim klasor
2. Një mësimdhënës për mësim klasor në paralelen e ndarë në Kërstec
3. Një edukatore për mësimin parafillor në paralelen e ndarë në Kërstec
4. Një mësimdhënës për Histori dhe Gjeografi
5. Një mësimdhënës për Gjuhë dhe komunikim
6. Një mësimdhënës për muzikë

### **SHFMU "25 Maj" Vraniç**

1. Një mësimdhënës për mësim klasor

### **SHFMU "Zenuni" Brod**

1. Një mësimdhënës për gjuhë boshnjake
2. Një mësimdhënës për Fizikë (10 orë )
3. Një mësimdhënës për Biologji dhe Kimi (18 orë )
4. Një mësimdhënës për Histori dhe Gjeografi
5. Një edukator/e për parafillor

### **SHFMU "Svetlost"- Krushevë**

1. Një mësimdhënës të Historisë
2. Një mësimdhënës për Kimi dhe Fizikë
3. Një mësimdhënës për Gjeografi
4. Një mësimdhënës për Muzikë
5. Një edukator/e për mësim parafillor

### **SHFMU "Restelica"**

1. Një mësimdhënës për Matematikë
2. Një mësimdhënës për Fizikë (16 orë)
3. Një mësimdhënës për Kimi (12 orë)
4. Një mësimdhënës për Biologji (16 orë)
5. Një mësimdhënës për Histori
6. Një mësimdhënës për Gjeografi
7. Një mësimdhënës për Muzikë (16 orë)
8. Katër mësimdhënës për mësim klasor

## SHML "Ruzhdi Berisha" Dragash

### Mësimi në gjuhën shqipe

1. Një mësimdhënës i lëndës së Matematikës (15orë )
2. Një mësimdhënës për lëndët e mjekësisë për mësim praktik
3. Një mësimdhënës për lëndët e mjekësisë për mësim praktik ( 10 orë)
4. Një mësimdhënës për lëndët e farmacisë ( 10 orë)
5. Një mësimdhënës të gjuhës angleze (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)

### Mësimi në gjuhën boshnjake

1. Një mësimdhënës për lëndë juridike
2. Një mësimdhënës për lëndët ekonomike
3. Një mësimdhënës të gjuhës angleze
4. Një mësimdhënës të matematikës
5. Një mësimdhënës për lëndët e mjekësisë

### I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.);
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj;
- Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës , duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2018, por në varësi të lirimit real të vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.

**Vërejtje:** Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë:03.08.2018  
Dragash

